

Tiranë, më 19.10.2020

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AL MANI TRADING” SHPK

Sot në datë 19.10.2020 (dy mijë e njëzetë), duke u bazuar në Kushtetutën R.SH dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe në Ligjin Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të *Biznesit*”, me vullnetin e tij të lirë ortaku i vetëm:

- **Z. AMJAD J. M. AL MANI** , i biri i Jamal dhe I Diana , lindur më 01.01.1990 , në Siri, dhe banues në Linze Dajt, Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit elektronik me Nr. 4313269 , do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me 100'000 (njëqind mijë) lekë, ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, nga ky Akt Themelimi dhe Statuti.

Neni 1
Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është “AL MANI TRADING” SHPK

Neni 2
Selia

Selia e shoqërisë është në adresën: Tiranë, Linze, Zona Kadastrale Nr.3266, Nr pasurie 155/29+2-3, Volumi 18, Faqe 109.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pakufizuar.

Neni 4

 1

Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Shoqëria do të mund të kryejë import eksport gjithashtu shitje dhe blerje me shumicë dhe pakicë të produktit të qymyrit, aluminit, plastikes dhe produkte të tjera të ngjashme që kanë lidhje me objektin e veprimtarisë. Gjithashtu shoqëria do të mund të kryerje import eksport të makinave si dhe shit-blerjen e tyre.

Neni 5

Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është 100'000 (njëqind mijë) lekë. Ky Kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakut i vetëm i shoqërisë **Z. AMJAD J. M. AL MANI**. Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të ortakut të vetëm.
- Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë 100'000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 6

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - Shitblerjes;
 - Trashëgimisë;
 - Dhurimit
 - Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj;
2. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë me miratimin e Asamblesë së ortakut të vetëm.
3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim;

Neni 7

Administratori

Me këtë Akt vetçaktohet Administrator i shoqërisë personi si më poshtë:

- **Z. AMJAD J. M. AL MANI**, i biri i Jamal dhe I Diana, lindur më 01.01.1990, në Siri, dhe banues në Linze Dajt, Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit elektronik me Nr. 4313269 I cili do të gendroje në detyrë për një afat 4-vjeçar.



2

Neni 8
Legjislacioni

Për sa nuk është shkruar në këtë Akt-Themelimi dhe Statut, do të bëhet në referim me dispozitat e legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 9
Gjuha

Ky Akt Themelimi është i përbërë në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, që kanë vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

“AL MANI TRADING” SHPK

AMJAD J. M. AL MANI

Amjad Almani

Amjad